



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

DEPARTAMENTI I VETËQEVERISJES LOKALE
DIVIZONI PËR NGRITJE TË KAPACITETEVE NË KOMUNA

RAPORT

PROGRAMI I TRAJNIMEVE PËR NËPUNËSIT E QEVERISJES LOKALE NË KOMUNAT E
REJA: GRACANICË , RANILLUG, KLLOKOT, PARTESH dhe KOMUNAT TJERA
Tetor - Dhjetor 2010

Informatë themelore mbi krijimin e komunave të reja

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me përgatitjen e planit të veprimit në vitin 2008 ka pasqyruar synimin strategjik të Qeverisë së Kosovës, për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efektiv të vetëqeverisjes lokale në të gjithë territorin e Kosovës për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës duke i kushtuar kujdes të veçantë nevojave të posaçme të komuniteteve jo shumicë në Kosovë.

Plani i veprimit për decentralizim është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë plan është formuar Grupi Ndërmintor për Decentralizim (GND).

Në kuadër të GND janë formuar 5 nëngrupe punuese ku njeri ndër këto nëngrupe punuese është edhe Nëngrupi për themelimin e Komunave të Reja.

Ky grup punues ka pasur për qëllim që të bëjë përgatitjet për themelimin e komunave të reja. I tërë ky proces ka qenë pozitiv dhe si rezultat janë themeluar të gjitha Ekipet Përgatitore Komunale që kanë bërë një punë produktive që është përmbyllur me sukses të plotë në procesin zgjedhor të mbajtur më 15 nëntor 2009, në të cilin pjesëmarrja e serbëve ka qenë e kënaqshme dhe si rezultat final kemi zgjedhjen e organeve demokratike në Komunën e Graçanicës, Kllokotit dhe Ranillugut, dhe komuna e Novobërdës e zgjeruar.

Në Qershor të vitit 2010 pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, është krijuar edhe komuna e katërt: Parteshi.

Ndërkaq, në vitin 2009 është krijuar Ekipi Përgatitor Komunal i Mitrovicës (EPK), për krijimin e komunës së re. Varësisht nga vendimet politike pritet të krijohet komuna e re në këtë pjesë të vendit , e cila është parashikuar me ligjin e ri për kufijtë administrativ.

Përmbledhje e shkurtër

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP) ka organizuar programin e trajnimit për nëpunësit e qeverisjes lokale të komunave të reja: Graçanicë, Ranillug, Klokot, Partesh si dhe të Komunave të tjera.

Programi i trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve profesionale në komunat e reja dhe ato ekzistuese ka për qëllim dhënien e kontributit të rëndësishëm në zhvillimin dhe ndërtimin e kapaciteteve për të siguruar qeverisje efektive në një të ardhme të afërt për komunat e reja.

Në këtë program trajnimi janë përfshirë nëpunësit civil të komunave të nivelit: udhëheqës, profesional dhe administrativ. Programi i trajnimit në përbërje të saj ka pasur dhjetë (10) module në të cilat janë trajtuar çështjet vitale të qeverisjes lokale dhe që është i domosdoshëm për suksesin e komunave të reja të dala nga procesi i decentralizimit dhe të vetë nëpunësve civil.

Pjesëmarrja në këto trajnime ka qenë e lartë. Gjithsejtë vijues të moduleve kanë qenë 149. Prej 149 pjesëmarrësve, 52 ose 36.36% kanë qenë pjesëmarrës nga komuniteti serb, ndërsa numri i përgjithshëm i pjesëmarrjes së gjinisë femërore ka qenë 72.

Ky program ka filluar në muajin tetor 2010 dhe ka përfunduar në muajin dhjetor 2010.

Në fund të përfundimit të 10 moduleve, më 17 dhjetor 2010 të gjithë pjesëmarrësit janë pajisur me çertifikata.

MODULET E TRAJNIMEVE

1. Planifikimi i buxhetit (trajnim dyditorë)
2. Barazia Gjinore dhe Funksionalizimi i Zyrës për Barazi Gjinore (trajnim dyditorë)
3. Korniza Ligjore e Organizimit dhe Funksionimit të Qeverisjes Lokale (trajnim dyditorë)
4. Zhvillimi dhe Implementimi i të Hyrave Vetanake Komunale (trajnim një ditorë)
5. Roli i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në Vetëqeverisjen Lokale (trajnim njëditorë)
6. Procedurat e Menaxhimit të Personelit (trajnim dyditorë)
7. Teknikat e Hartimit të Legjislacionit (trajnim dyditorë)
8. Plani , Organizimi i Punës dhe Puna Ekipore (trajnim dyditorë)
9. Zyra e Regjistrimit Civil (trajnim dyditorë)
10. Menaxhimi i Ciklit të Projektit (trajnim dyditorë)

Programi i trajnimeve për nëpunësit e qeverisjes lokale në komunat e reja :
Graçanicë , Ranillug, Klllokot, Partesh dhe Komunat tjera

1. MODULI I PARË ME TEMËN:

Planifikimi i Buxhetit

30 dhe 31 tetor 2010, në sallën e takimeve në UNDP.

Trajner: Xhelil Bekteshi, Drejtor i buxhetit dhe pronave , në Komunën e Prishtinës
Pjesëmarrësit: Gjithsejtë pjesëmarrës kanë qenë 13 nga komunat e reja: Graçanicë, Ranillug, Partesh, Klllokot dhe anëtarët e Ekipit Përgatitor Komunal të Mitrovicës (EPK).

1. 7 prej tyre nga nacionaliteti serb (4 femra dhe 3 meshkuj)
2. 6 nga nacionaliteti shqiptar (2 femra dhe 4 meshkuj)

Grupet e synuara: Menaxher, shërbyes civil , nëpunës të buxhetit

Qëllimi i këtij trajnimi ka qenë që pjesëmarrësit të përfshihen drejtpërdrejt në procesin e planifikimit të buxhetit, të zhvillojnë aftësi të duhura për identifikimin e nevojave dhe planifikim sa më real të buxhetit si dhe njohjen sa më të gjerë të procedurave ligjore në këtë proces.



Trajner: Xhelil Bekteshi



Prezantimi i punës në grupe, komuna Partesh

2. MODULI I DYTË ME TEMËN :

Barazia Gjinore dhe FunkSIONALIZIMI I Zyrës për Barazi Gjinore

11 dhe 12 nëntor 2010 në sallën e takimeve në MAPL .

Trajner : Afërdita Strellci, Ish- Anëtare e Ekipit Përgatitor Komunal në Graçanicë
Pjesëmarrësit: Gjithsejtë pjesëmarrës kanë qenë 14 nga komunat e reja : Klllokot, Partesh, Ranillug, dhe pjesëmarrës nga komunat ekzistuese : Novobërdë, Obiliq, Shtërpçë dhe MAPL/ divizioni për të drejtat e njeriut.

1. 6 prej tyre nga nacionaliteti serb(4 femra dhe 2 meshkuj)
2. 1 nga nacionaliteti turk (femër)
3. 7 nga nacionaliteti shqiptar (6 femra dhe 1 mashkull)

Grupet e synuara : Departamenti i burimeve njerëzore, drejtorët , shërbyesit civil.

Qëllimi i këtij trajnimi ka qenë rritja e vetëdijes për respektimin e barazisë gjinore, duke synuar që në fund të trajnimit pjesëmarrësit të kenë dijeni mbi termat kyçe në fushën e barazisë gjinore, mjeteve dhe mekanizmave gjinor në dispozicion dhe shembuj të praktikave të mira në nivel lokal të qeverisjes. Trajnimi ka qenë interaktiv dhe janë diskutuar çështjet kryesore me interes për grupet e grave dhe burrave në komuna, pengesat dhe mundësitë për të përmirësuar zbatimin e parimit të barazisë.



Trajner: Afërdita Strellci



Grupet punuese: Kllokot, Partesh , MAPL



Prezantimi i punës në grupe, Kllokot

3. MODULI I TRETË ME TEMËN :

Korniza Ligjore e Organizimit dhe Funksionimit të Qeverisjes Lokale **18 dhe 19 nëntor në sallën e takimeve në MAPL .**

Trajner : Agron Maxhuni , Drejtor në Departamentin Ligjor në MAPL

Pjesëmarrësit: Gjithsejtë pjesëmarrës kanë qenë 15, nga komunat e reja: Klllokot, Rranillug, anëtarët e Ekipit Përgatitor Komunal të Mitrovicës (EPK), komuna Shtërpçë dhe nga MAPL

1. 5 prej tyre nga nacionaliteti serb (3 femra dhe 2 meshkuj)
2. 10 nga nacionaliteti shqiptar (4 femra dhe 6 meshkuj)

Grupet e synuara : Zyrtar ligjor , nëpunës administrativ

Qëllimi i trajnimit ka qenë informimi i zyrtarëve komunalë me ndryshimet legjislative në tërë kornizën legjislative që e mbulon Qeverisjen Lokale në Kosovë. Në mënyrë të veçantë analizimi dhe pasqyrimi i ndeshjeve eventuale të normave juridike si pjesë e pakos së re legjislative të kësaj fushe (Kushtetuta e Republikës së Kosovës me ligjet e veçanta që rregullojnë Qeverisjen Lokale në Kosovë). Aspekt tjetër, ka qenë edhe analizimi dhe pasqyrimi krahasues i modeleve të ndryshme të Qeverisjes Lokale në Evropë.



Trajner: Agron Maxhuni



Diskutime gjatë trajnimit: EPK, Klllokot, Shtërpçe

4. MODULI I KATËRT ME TEMËN :

Zhvillimi dhe Implementimi i të hyrave vetanake të Kosovës **23 Nëntor në sallën e takimeve në MAPL .**

Trajner: Afrim Krasniqi, Drejtor i departamentit të Administratës së Përgjithshme në komunën e Fushë Kosovës.

Pjesëmarrësit: Gjithsejtë pjesëmarrës kanë qenë 15, nga komunat e reja: Graçanicë, Rranillug, Klllokot, anëtarët e Ekipit Përgatitor Komunal të Mitrovicës (EPK), dhe pjesëmarrës nga komuna e Shtërpçës dhe MAPL.

- 1 6 prej tyre nga nacionaliteti serb (1 femër dhe 5 meshkuj)
- 2 9 nga nacionaliteti shqiptar (4 femra dhe 5 meshkuj)

Grupet e synuara : Zyrtarët e departamenteve të buxhetit dhe financave

Qëllimi i trajnimit ka qenë informimi i pjesëmarrësve me rregulloret mbi të hyrat komunale nga taksat, ngarkesat, gjobat dhe i të hyrave nga tatimi në pronë si dhe menaxhimi i tyre. Gjithashtu është shpjeguar hollësisht lidhshmëria në mes Qeverisë, Komunës, Shoqërisë Civile dhe Komunitetit të Biznesit, ku janë shpjeguar edhe grantet e jashtëzakonshme apo ndihma financiare që vlen nga jashtë.



Trajner: Afrim Krasniqi



Pjesëmarrësit

5. MODULI I PESTË ME TEMËN :

Roli i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në Vetëqeverisjen Lokale **24 Nëntor në sallën e takimeve në MAPL .**

Trajner : Rozafa Ukimeraj, Drejtor i Departamentit për Vetëqeverisje Lokale

Pjesëmarrësit: Gjithsejtë pjesëmarrës kanë qenë 12, nga komunat e reja: Klllokot, Rranillug, Partesh, anëtarët e Ekipit Përgatitor Komunal të Mitrovicës (EPK), dhe pjesëmarrës nga komuna e Shtërpçës , Obiliqit dhe MAPL.

- 1 5 prej tyre nga nacionaliteti serb (5 femra)
- 2 7 nga nacionaliteti shqiptar (4 femra dhe 3 meshkuj)

Grupet e synuara : Zyrtarët e lartë, shërbyesit civil .

Qëllimi i trajnimit ka qenë që të rrit të kuptuarit nga pjesëmarrësit së pari për historikun e zhvillimit të pushtetit lokal në Kosovë, për procesin e decentralizimit dhe funksionet e vetëqeverisjes lokale, prezantim i fakteve, argumentet e nevojshme dhe kushtet aktuale të procesit të decentralizimit në Kosovë dhe në vendet tjera.



Trajner: Rozafa Ukimeraj



Pjesëmarrësit

6. MODULI I GJASHTË ME TEMËN :

Procedurat e Menaxhimit të Personelit

30 Nëntor dhe 1 Dhjetor 2010 në sallën e takimeve në MAPL .

Trajner : Nebojša Azdejković , Drejtor, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut

Pjesëmarrësit: Gjithsejtë pjesëmarrës kanë qenë 15, nga komunat e reja: Graçanicë, Ranillug, Partesh, Klokot, anëtarët e Ekipit Përgatitor Komunal të Mitrovicës (EPK) dhe pjesëmarrës nga komuna e Obiliqit dhe MAPL .

- 1 8 prej tyre nga nacionaliteti serb (5 femra dhe 3 meshkuj)
- 2 1 nga nacionaliteti boshnjak (1 femër)
- 3 6 nga nacionaliteti shqiptar (2 femra dhe 4 meshkuj)

Grupet e synuara : Departamenti i burimeve njerzore, drejtorët , shërbyesit civil

Qëllimi i trajnimit ka qenë të ofroj njohuri gjithpërfshirëse dhe të shtjelloj specifikat dhe koherencën ndërmjet segmenteve menaxhuese si dhe me faktorët tjerë organizativ.



Trajner: Nebojsa Azdejkovic



Diskutime gjatë trajnimit: Klokot, Rranillug



Prezantimi i grupit punues

7. MODULI I SHTATË ME TEMËN :

Teknikat e Hartimit të Legjislacionit

7 dhe 8 Dhjetor 2010 në sallën e takimeve në MAPL .

Trajner : Agim Salihu, Shef i zyrës ligjore në komunën e Prishtinës

Pjesëmarrësit: Gjithsejtë pjesëmarrës kanë qenë 19. Nga komunat Graçanicë, Ranillug, Partesh, Klokot, anëtarët e Ekipit Përgatitor Komunal të Mitrovicës (EPK) dhe pjesëmarrës nga komuna e Obiliqit , Novobërdës dhe MAPL .

- 1 5 nga nacionaliteti serb (5 Femra)
- 2 14 shqiptarë (7 Femra dhe 7 Meshkuj)

Grupet e synuara : Zyrtarët ligjor komunal, shërbyesit civil

Qëllimi i trajnimit në fushën e hartimit të akteve normative synon rritjen e nivelit profesional të shërbyesve civil, në drejtim të hartimit të akteve normative (rregullore, vendime dhe akte tjera administrative), interpretimin e tyre, si dhe përgjithësimin të praktikës në këtë fushë, duke pasur si qëllim kryesor përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e efektivitetit të akteve normative gjatë zbatimit.



Trajner: Agim Salihu



Prezantimi i grupit punues

8. MODULI I TETË ME TEMËN :

Plani, Organizimi i Punës dhe Puna Ekipore

9 dhe 10 Dhjetor 2010 në sallën e takimeve në MAPL .

Trajner : Skender Berisha, Koordinator për cilësinë e trajnimit. KEK - qendra e trajnimeve
Pjesëmarrësit: Gjithsejtë pjesëmarrës kanë qenë 19, nga komunat e reja: Kllokot, Partesh anëtarët e Ekipit Përgatitor Komunal të Mitrovicës (EPK) dhe pjesëmarrës nga komuna e Obiliqit , Novobërdës , Shtërpce dhe MAPL .

- 1 7 nga nacionaliteti serb (6 Femra dhe 1 Mashkull)
- 2 1 nga nacionaliteti boshnjak (1 Femër)
- 3 11 shqiptarë (5 Femra dhe 6 Meshkuj)

Grupet e synuara : Shërbyesit Civil

Qëllimi i kursit ka qenë ngritja e nivelit të njohurive dhe shkathtësive për planifikimin dhe organizimin e punës, organizimin e kohës dhe vendosjen e prioriteteve, njohuri në procesin e komunikimit dhe shkathtësi në punë ekipore, një organizim më i mirë i punës së departamentit apo ndonjë njësie tjetër ashtu që kjo të bëhet në mënyrë më efektive.



Trajner: Skender Berisha



Puna në grupe: Partesh, Kllokot, Shtërpce, Obiliq, EPK



Puna në grupe

9. MODULI I NËNTË ME TEMËN :

Zyra e Regjistrimit Civil është mbajtur

14 dhe 15 Dhjetor 2010 në sallën e takimeve në MAPL .

Trajner : Avni Nebiu, Drejtor i Administratës dhe Personelit në Komunën e Dragashit
Pjesëmarrësit: Gjithsejtë pjesëmarrës kanë qenë 12, nga komuna e re: Kllokot, anëtarët e Ekipit Përgatitor Komunal të Mitrovicës (EPK) , pjesëmarrës nga komuna e Obiliqit.

- 1 2 nga nacionaliteti serb (2 Femra)
- 2 9 nga nacionaliteti shqiptar (4 Femra dhe 5 Meshkuj)

Grupet e synuara : Zyrtarët e regjistrimit civil në komuna, Shërbyesit civil

Qëllimi i këtij ka qenë që pjesëmarrësit të fitojnë njohuri themelore praktike për komponentët e regjistrimit civil, si dhe rëndësinë e shumëfishtë që ka regjistrimi civil sepse mundëson përcaktimin e drejtimeve në planin politik, ekonomik, shoqëror , demografik dhe fusha të tjera.



Trajer: Avni Nebiu



Pjesëmarrësit

10. MODULI I DHJETË ME TEMËN :

Menaxhimi i Ciklit të Projektit

16 dhe 17 Dhjetor 2010 në sallën e takimeve në MAPL .

Trajner : Bojana Gudžić , Trajnere nga Communication for Social Development, CSD

Pjesëmarrësit: Gjithsejtë pjesëmarrës kanë qenë 16, nga komuna e re: Ranillug, anëtarët e Ekipit Përgatitor Komunal të Mitrovicës (EPK) , pjesëmarrës nga komuna e Obiliqit, Shtërpce dhe MAPL.

- 1 4 nga nacionaliteti serb (2 Femra dhe 2 Meshkuj)
- 2 1 nga nacionaliteti boshnjak (1 Femër)
- 3 11 nga nacionaliteti shqiptar (4 Femra dhe 7 Meshkuj)

Grupet e synuara : Drejtorët e komunave, Shërbyesit civil

Qëllimi i këtij trajnimi ka qenë që pjesëmarrësit të fitojnë njohuri themelore praktike për teknikat e menaxhimit të projektit. Të njihen me metodën e qasjes së fazave të krijimit të projektit, (identifikimin e problemit, implementimin dhe vlerësimin e projektit), të inkurajohen të planifikojnë dhe iniciojnë projekte dhe nëse punojnë në projekte të ngrisin efektivitetin në atë projekt.

Ky modul ka përfshirë identifikimin e ciklit të projektit dhe hapat e kornizës ligjore , fazat e shkrimit të projektit përmes analizës së palëve me interes, analizën e problemit, analizën e objektivave dhe analizën strategjike.



Trajner: Bojana Gudžić



Pjesëmarrësit



Puna në grupe

Këto trajnime kanë përfunduar me 17 dhjetor 2010, ku është bërë edhe ndarja e 149 certifikatave për të gjithë pjesëmarrësit në këtë program të trajnimit .



Parviz Fartash , drejtor i UNDP-së gjatë shpërndarjes së certifikatave

Raporti përgatitur nga : Arta Pllana, eksperte lokale – arta.pllana@ks-gov.net
Projekti: Mbështetje Decentralizimit në Kosovë (SDK) - UNDP
Menaxher i Projektit : Rreze Duli – rreze.duli@undp.org
Rozafa Ukimeraj , Drejtor në Dep. për Vetëqeverisje Lokale / MAPL - rozafa.ukimeraj@ks-gov.net

